

Nv. prot 406
Dato 15.6.17

Tiranë, më 14.06.2017

INFORMACION KQZ-SË

Për zyrat elektorale të Subjektit Zgjedhor Partia Socialiste në Bashkinë Gramsh

Në vijim të raportimeve të bëra në lidhje me monitorimin e fushatës zgjedhore të subjektit zgjedhor Partia Socialiste, me cilësinë e Ekspertëve Financiarë të emëruar nga KQZ për të kryer monitorimin, ju raportojmë si më poshtë:

Më datë 14.06.2017, njoftohemi nga KQZ për verifikimin e një problematike të ngritur nga subjekti zgjedhor, Partia Demokratike, në lidhje me afishimin e një baneri me përmasa të mëdha në qytetin e Gramshit nga subjekti për të cilin kemi detyrimin të monitorojmë, Partia Socialiste.

Sipas informacionit të marrë, Partia Socialiste nuk ka njoftuar për hapjen e zyrës elektorale dhe se nuk ekziston aktualisht një zyrë elektorale e subjektit Partia Socialiste në ndërtesën ku është vendosur baneri.

Menjëherë me marrjen e informacionit ju dërgua shkresë zyrtare dhe e-mail Kryetares së Bashkisë Gramsh, me anë të të cilit kërkohej vënia në dispozicion e listës së zyrave elektorale të Partisë Socialiste në territorin e bashkisë Gramsh, si dhe të na sqaronte në lidhje me problematikën e mësiperme. Gjithashtu nga ana jonë nisi verifikimi në terren.

Nga verifikimi u konstatua se:

- Në qytetin e Gramshit në adresën lagjia "Holta" Gramsh, ishte hapur një zyrë elektorale me siperfaqe 324 m². Për këtë zyrë elektorale disponohej dhe një kontrate qeraje midis znj.Elvira Koçi dhe përfaqësuesit të Partisë Socialiste në qytetin e Gramshit Z.Klodian Tace. (bashkëngjitur kontrata).

Sic mund të shihet nga fotot bashkëngjitur, baneri është vendosur në ambjentet e zyrës elektorale. Duke iu referuar Nenit 24/2 pika 5 te Ligjit Nr.90/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike" të ndryshuar", konstatojmë se baneri nuk është më larg se 5 metra nga zyra elektorale, dhe për këtë afishim nuk ka shkelje te ligjit.

Për sa i përket plotësimit të kriterit për ngritjen e zyrave elektorale jo më shumë se 1 për lagje dhe se subjektit duhet të deklarojë adresën e zyrës, pranë bashkisë përkatëse jemi në pritje të përgjigjes së Kryetares së Bashkisë Gramsh.

Ky informacion do të jetë pjesë e raportit të ndërmjetëm favor.

Bashkëlidhur janë fotot e zyrës elektorale, si dhe kontrata e qerasë.

Ekspertët finansiar

Silvana Gjikdhima

Stoli Laze

